

Përgjigje Peter Faith-it
Ruajtja e karakterit të Prizrenit – një perspektivë vendore

Përgjigje e Koalicionit ad-hoc të OJQ-ve të Prizrenit në mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit, ndaj letrës së Peter Faith (ICR), botuar më 26 gusht 2011

I nderuari Z. Faith,

Na lejoni që në fillim të përgjigjes sonë, të ju falenderojmë sinqerisht për vullnetin dhe angazhimin tuaj në drejtim të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të Prizrenit. Duke u thirrur në parimet demokratike të debatit të hapur dhe pjesëmarrës, më poshtë po i listojmë disa nga shqetësimet tona mbi letrën tuaj “Ruajtja e karakterit të Prizrenit”, qasjen tuaj në mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe mbi procesin e hartimit të projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Që në fillim të letrës suaj keni dhënë një konstatim të gabuar ose thjesht jeni në mohim të një fakti – Kuvendi i Kosovës nuk po shqyrton legjislacionin e ri për Qendrën Historike të Prizrenit, por ai ka refuzuar projekt-ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Dhe ky refuzim është shfaqur si në Komisionin përkatës Parlamentar, i cili unanimisht ka votuar për të kthyer këtë projekt-ligj të dobët në qeveri, ashtu edhe në seancë plenare të Kuvendit, ku është votuar kundër projekt-ligjit. Nga fjalë pasuese – të cilën e përdorni si uvertyrë për pjesën tjetër të letrës suaj – ku ju pretendoni të na “tregoni se pse trashëgimia kulturore e Kosovës meriton të mbrohet në mënyrë të duhur me ligj” krijohet përshtypja se po i flitni një shoqërie të pacivilizuar, e cila nuk e ka idenë se çfarë rëndësie ka trashëgimia kulturore. Jemi thellësisht të brengosur që, mbi 12 vite pas ardhjes së administrimit ndërkombëtar në Kosovë, shoqëria jonë vazhdon të dëgjojë ligjërata të këtilla “iluminuese”.

Pajtohem plotësisht me konstatimin tuaj se “trashëgimia kulturore e Prizrenit u dëmtua rëndë nga konfliktet e mëparshme dhe aktualisht është e rrezikuar nga zhvillimi i përshtypshëm urban”. Për pjesën e parë të konstatimit tuaj kemi një pyetje: a keni menduar ndonjëherë për çështjen e kompensimit të dëmeve që iu shkaktuan trashëgimisë kulturore të Prizrenit nga konfliktet e mëparshme, e sidomos nga konflikti i fundit? Për pjesën e dytë të konstatimit tuaj kemi një alternativë. Të gjitha mekanizmat për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Prizrenit ekzistojnë një kohë të gjatë. Karakteri i Prizrenit shumë lehtë mund të mbrohet nga efektet negative të zhvillimit të përshtypshëm urban. Për shembull, mendimet (pëlqimet) të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren për ndërtime do të duhej të ishin profesionale, pastaj ato do të duhej të respektoheshin nga Drejtoria për Urbanizëm, të mbikëqyreshin nga Inspektorati i Ndërtimit, në rast të kontesteve do të duhej të funksionin gjykatat lokale, Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës së Parë Historike (i miratuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit më 2008) do të duhej të gjente implementim, dhe shumë veprime tjera. Problemi i trashëgimisë kulturore në Prizren nuk është ai i legjislacionit apo ndërtimit institucional, por pak më struktural, është problem i forcimit dhe zbatimit të ligjshmërisë.

Më tej në letrën tuaj shpjegoni për përmbajtjen e projekt-ligjit dhe për ndalesat që ai vendos në ndërtime dhe projekte që rrezikojnë ruajtjen e karakterit të qendrave historike. Edhe një herë, legjislacioni aktual dhe institucionet ekzistuese shtetërore të Kosovës (në nivel qendror dhe lokal) ofrojnë bazë të gjerë ligjore për parandalimin e këtyre veprimeve degraduese. E tëra që duhet bërë është respektimi i këtij legjislacioni dhe veprimi i duhur institucional. Dhe menjëherë pas këtij spjegimi, ju përmendni obligimin që del nga Pakoja e Ahtisaarit dhe që lidhet me themelimin e zonës së veçantë të mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit. Dhe pikërisht këtu, ne mendojmë se qëndron motivi juaj kryesor (ndoshta dhe i vetëm) për t’u angazhuar kaq fuqishëm për shtyrjen përpara të ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit (paralelisht me atë për fshatin Hoçë e Madhe).

Më tutje, nuk pajtohem as me konstatimin tuaj se “ligji nuk do t’i japë status ekstraterritorial ose pushtet të tepruar ndonjë komuniteti të veçantë në Prizren”. Përmbajtja aktuale e projekt-ligjit parasheh nevojën për të kërkuar pajtimin e Kishës Ortodokse Serbe për çdo aktivitet, i cili prek pronat e Kishës Ortodokse Serbe në Qendrën Historike të Prizrenit. Edhe pse në dukje të parë lihet përshtypja se ky ligj i trajton si të barabartë të gjitha komunitetet fetare, ky formulim, i jep një përparësi shtesë Kishës Ortodokse Serbe, derisa ky privilegj nuk i ofrohet komuniteteve tjera fetare.

Kamuflimi i rradhës në tekstin e projekt-ligjit ka të bëjë me përfaqësimin e shoqërisë civile në Komitetin për Qendrën Historike. Në projekt-ligj thuhet se ky Komitet do të përbëhet nga gjashtë anëtarë të shoqërisë civile, por më poshtë ofrohet kjo ndarje: një anëtar nga Bashkësia Islame, një anëtar nga Kisha Ortodokse Serbe, një anëtar nga Kisha Katolike, dhe së paku dy nga tre anëtarët e mbetur të jenë ekspertë të njohur në fushën e trashëgimisë kulturore dhe ju, në letrën tuaj kërkon që kjo të mirëpritet nga shoqëria civile. Me një formulim të këtillë, që jep projekt-ligji, shumë lehtë mund të përfundojmë me vetëm një (në rastin më të keq me asnjë) anëtar nga ajo çfarë ne realisht konsiderojmë shoqëri civile në Kosovë.

Paradoksi tjetër në letrën tuaj është thirrja juaj për mosdevijimin e debatit rreth trashëgimisë kulturore nga sfera demokratike, akademike dhe shoqërore në atë nacionaliste. Derisa bëni një thirrje të këtillë, brenda letrës suaj përmendni të ashtuquajturat “objekte ortodokse serbe”. Na lejoni të bëjmë të qartë një element: shoqëria civile dhe qytetarët e Prizrenit angazhohet pikërisht kundër futjes së dimensioneve të etnisë në trashëgiminë kulturore. Prandaj, këtë thirrje (apel) tuajën, na duhet të ju kthejmë mbrapsh dhe të ju lusim të ndërroni qasjen tuaj, duke siguruar paritet në mënyrën se si i trajtoni objektet e trashëgimisë kulturore në Prizren (dhe në pjesët tjera të Kosovës).

Ne në asnjë mënyrë nuk jemi kundër këtij ligji, por nuk mund të pajtohemi me mënyrën se si është udhëhequr procesi i hartimit të tij dhe me përpjekjen për të kontrabanduar nëpër Kuvendin e Kosovës një ligj kaq të ndieshëm për funksionalitetin e qytetit të Prizrenit. Shoqëria civile ka kohë që i ka prezantuar shqetësimet e veta në lidhje me këtë proces. Dy nga shqetësimet tona kryesore janë: 1. Prosesi i hartimit të këtij projekt-ligji, që zgjat rreth dy vjet, ka dëshmuar për qasjen përjashtuese të institucioneve shtetërore të Kosovës dhe faktorit ndërkombëtar ndaj shoqërisë civile dhe qytetarëve kur bëhet fjalë për trashëgiminë kulturore; dhe 2. E gjithë përmbajtja e projekt-ligjit përbëhet nga ndalesa, ndëshkime, procedura, emergjenca, favorizime dhe mbindërtime institucionale, ndërsa Qendra Historike e Prizrenit ka nevojë për një ligj që fut menaxhimin urban si koncept të ruajtjes dhe zhvillimit.

Kalicioni ad-hoc i OJQ-ve të Prizrenit në mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit, ka përgatitur një listë rekomandimesh për një proces të hapur të hartimit dhe miratimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit. Ne kërkojmë që: 1. Projekt-ligji të hartohet nga fillimi, pasi që teksti aktual i projekt-ligjit ka të meta serioze dhe nëse punohet mbi këtë version, ka mundësi të përfundojmë me një përmbajtje edhe më të dobët dhe problematike, 2. Të themelohet një Grup Ndërsektoral Punues për hartimin e projekt-ligjit dhe sponsorizimi i projekt-ligjit të bartet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Ministrinë e Kulturës, Departamentin e Trashëgimisë Kulturore, 3. Të realizohen konsultime të gjera publike me palët relevante në të gjitha fazat e hartimit të projekt-ligjit, dhe 4. Të organizohet një konferencë ndërkombëtare për të validuar përfundimisht përmbajtjen e projekt-ligjit (respektimi i standardeve ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore, menaxhimi urban dhe funksionaliteti, zhvillimi lokal ekonomik, etj.).

Në mbështetje të këtyre rekomandimeve, shoqëria civile e Prizrenit, në bashkëpunim me komunitetet relevante të qytetit, është duke ndërmarrë veprime konkrete për të pasqyruar vullnetin e qytetarëve të Prizrenit tek autoritetet shtetërore të Kosovës. Besojmë që ky vullnet i qytetarëve të Prizrenit do të respektohet përpikmërisht nga institucionet shtetërore të Kosovës. Dhe në të njëjtën kohë, besojmë që Zyra Civile Ndërkombëtare do të luajë rolin e vet në përputhje me këtë vullnet.

Koalicioni ad-hoc i OJQ-ve të Prizrenit në mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit (EC Ma Ndryshe, Dokufest, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren, X40 dhe European Union Integration Resource Center)